



EPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
DREJTORIA E UJITJES DHE KULLIMIT FIER

Nr. 60/1 Prot

Fier më 17.03 2026

RAPORTIMI I MONITORIMIT TE PLANIT TE INTEGRITETIT 2025
DREJTORIA E UJITJES DHE KULLIMIT FIER

Tabela e përmbajtjes

1. Hyrje
- 2 .Metodologjia e monitorimit.....
- 3.progresi ne zbatim dhe gjetjet e raportit
- 4.konkluzione dhe rekomandime

1.HYRJE

Ky raportim monitorimi synon te vleresoj nivelin e zbatimit te Planit te integritetit te Drejtorise se Ujitjes dhe Kullimit Fier (DUKFier)per periudhen 2024.

Plani eshte hartuar ne perputhje me objektivat e Strategjise Ndersektoriale Kunder Korrupsionit dhe ka per qellim rritjen e integritetit institucional dhe transparences ne ofrimin e puneve dhe sherbimeve publike per komunitetin ku krzen leto pune dhe sherbime .

2.Metodologjia e Monitorimit

Motitorimi i zbatimit të Planit të Integrimit në DUK Fier është kryer nëpërmjet :

- Vlerësimi i punës në çdo sektor për stafin , nëpërmjet takimeve me anëtarët e grupit të punës
- Analizë e rrishtit në periudha tre mujore gjashtë mujore dhe vjetore dhe masat e zbatuara ,për të diskutuar rrishtet e secilit sektor.
- Raportim të rregullt nga strukturat përgjegjëse për implementimin e masave
- Analizë e veprimtarisë së institucionit dhe sektoreve përkatëse
- Vlerësimi i dokumentacionit dhe praktikave institucionale

Kordinatori i Integritetit ka kryer vlerësime ,duke analizuar përparimet dhe sfidat në zbatimin e planit të integritetit

-Grupi i Punës për Hartimin e Planit të Integritetit

Emri	Pozicioni
Evarist Kolici	Kordinator \përgjësës sektorit teknik DUK fier
Olsi Shkreli	Përgjësës sektorit gjirokaste në DUK Fier
Behar Keko	Përgjësës sektoriot Hidrovor makineri
Ferdinand Dervishi	Përgjësës sektorit Lushnje
Meme Habazaj	Ing \Specialiste sektorit Vlore
Arsino Naska	Përgjësës Finances
Eliana Metaj	Specialiste juriste në sektorin finance

3.Progresi në zbatimin e planit të integritetit

- Objektivat strategjike për vitin 2025

Nr	Objektivi
1	Arritja e rezultateve optimal dhe të qëndrueshme të zhvillimit dhe të menaxhimit të istemit të ujitjes
	- Zhvillimi i infrastruktures
	- Menaxhimi i sistemit të ujitjes
2	Arritja e rezultateve optimal dhe të qëndrueshme të zhvillimit dhe të menaxhimit të sistemit të kullimit
	- Zhvillimi I sistemit të kullimit
	- Administrimi i sistemit të kullimit
3	Arritja e rezultateve optimal dhe të qëndrueshme të zhvillimit dhe të menaxhimit të sistemit të mbrojtjes nga përmbytjet
4	Permisimi i sistemit te menaxhimit te burimeve njerezore dhe forcimi i kapaciteteve njerezore ne lidhje me etiken dhe integritetin

3.1 Arritja e rezultateve optimal dhe të qëndrueshme të zhvillimit dhe të menaxhimit të istemit të ujitjes me dy nenobjektiva

- Zhvillimi i infrastruktures dhe Menaxhimi i sistemit të ujitjes.

Gjendja aktuale :Jane përdorur me eficenc fondet e të akorduara nga buxheti i shtetit për përmirësimin e asdministrimit të sistemit te Kullimit, duke ndjekur me përpikmëri udhëzimet për rehabilitimin, modernizimin dhe zhvillimin e skemave të ujitjes. Keto jane te indentifikuara me shkresat e mara nga bashkite perkatese si dhe realizimet e tzre jane te dokumentuara me situacione perkatese deri ne ,akt kolaudimin e objektit

Te gjitha objektet e planifikuara dhe te miratuara nga MBZHR per permisimin e sisitemit ujitje , jane realizuar 90 %

Permisime : Jane bere koordinime i punës me Njësitë e Ujitjes dhe Kullimit të bashkive, per hartimin e identifikimin e përparësive për sistemin e ujitjes, nisur kjo nga identifikimi i kërkesave për nevoja para se të fillojë sezoni i ujitjes dhe kjo eshte realizuar .

Keto jane te indentifikuara me shkresat e mara nga bashkite perkatese si dhe realizimet e tyre jane te dokumentuara me situacione perkatese deri ne ,akt kolaudimin e objektit.

- Rritje e sipërfaqes së tokës që ujitje tbazuar në punën vjeotre

- Ndryshime në prodhimin dhe produktivitetin e kulturave si rrjedhojë e përmirësimit të infrastrukturës së ujitjes

- Rritje e produktivitetit të tokave

Sfida :Mungesa e mjeteve të levizjes për arritjen në kohë të çdo problematike të ndodhur .

3.2 Arritja e rezultateve optimal dhe të qëndrueshme të zhvillimit dhe të menaxhimit të sistemit të kullimit me dy nën objektivë

- Zhvillimi i sistemit të kullimit dhe Administrimi i sistemit të kullimit

Gjendja aktuale :Jane identifikuar nevojat për ndërhyrje në sistemin e kullimit ekzistues për të ruajtur kapacitetet e projektuara, si dhe për identifikimin e nevojave për rritje të kapacitetit të kullimit me fondet e miratuara nga MBZHR , duke identifikuar i zonat problematike lidhur me kullimin dhe marrja e masave për eliminimin e tyre (largimin e dherave dhe pastrimin e tyre nga kanalet kulluese), pasi kullimi është i rëndësishëm pasi parandalon dëmtimet në tokat bujqësore, mbron nga përmbytjet si dhe është parakusht për ujitjen e duhur)dhe janë realizuar 90 %dhe në fund të çdo punimi janë bërë kolaudimet e punimeve

Permisime :Jane bërë monitorime të vazhdueshme nga Sektori Teknik dhe ai i Hidrovor - Makineri me qëllim kryerjen e punimeve në mënyrën e duhur dhe përdorimin e makinerive në mënyrën e duhur, për të siguruar ndjekjen e grafikut të punimeve të miratuar në fillim të vitit.

Jane bërë kontrolle të vazhdueshme të objekteve edhe pasi janë përfunduar punimet, në mënyrë që të sigurojë mbarrëvajtjen e punës së sistemit kullues dhe kjo duke bërë procesverbalet përkatëse .

Sfida :Mungesa e mjeteve të levizjes për arritjen në kohë të çdo problematike të ndodhur .

3.3 Arritja e rezultateve optimal dhe të qëndrueshme të zhvillimit dhe të menaxhimit të sistemit të mbrojtjes nga përmbytjet

Gjendja aktuale :Eshtë bërë identifikimi i veprave të mbrojtjes nga përmbytjet duke i renditur ato sipas riskut potencial, me qëllim identifikimin e problematikave kyçe për të përcaktuar dhe nevojat për ndërhyrje, për të mbrojtur zonat e populluara të rrezikuara nga përmbytjet.

Permisimi :Kërkesa për projekte të reja dhe zbatimin e tyre për mbrojtjen nga përmbytjet janë ndjekur në mënyrë rigoroze nga specialistet e Duk Fier .

Uljë e nivelit të dërmeve të shkaktuara nga përmbytjet

Përmirësim i infrastrukturës së mbrojtjes

Sfida :Mungesa e mjeteve të levizjes për arritjen në kohë të çdo problematike të ndodhur .

3.4 Permisimi i sistemit të menaxhimit të burimeve njerezore dhe forcimi i kapaciteteve njerezore në lidhje me etiken dhe integritetin

Gjendja aktuale :Struktura e institucionit ka 168 punonjës miratuar me VKM 78 datë 07.05.2024 nuk ka vende vakante .

Permisime

- Procesi i rekrutimit është permisuar ,por mungesa e një specialisti IT mbetet problematike si dhe paisja e tre hidrovoreve me nga dy punonjës pasi janë objekte të rëndësishme të vecante.
- Është rritur numri i trajnimeve në ASPA

Sfida :Nevoja për plotësimin me kapacitetin e punës në hidrovore .

Vlerësimi i progresit :90 % i zbatimit të masave

-Menaxhimi i dokumentacionit dhe arkivimi

Gjendja aktuale:dokumentacioni plotësohet dhe ruhet sipas rregullave në fuqi

Permisime :jane zbatuar procedurat me të standartizuara për administrimin e dokumenteve

Sfida duhet të rritet digitalizimi i arkivës për të siguruar akses me të shpejtë dhe siguri në dorëzimin e dokumentacionit të prodhuar në ditë.

Vlerësimi i progresit: 80% i zbatimit të masave

-Menaxhimi financiar

Gjendja aktuale :proceset financiare ndjekin rregullat përkatëse dhe nuk ka pasur shkelje të identifikuar

Permisime :jane respektuar afatet për raportimin financiar dhe nga auditimet nuk ka pasur parregullsi.

Sfida :Rritja e transparencës në publikimin e raporteve financiare për interesin publik .

Vlerësimi i progresit :90% i zbatimit të masave .

-Risqet e integritetit dhe vlerësimi i tyre

Fusha	Pershkrimi i situates	Risku i integritetit
-------	-----------------------	----------------------

Menaxhimi financiar	Nuk jane konstatuar probleme me dokumentacionin financiar ,buxhetin apo prokurime .	Pa risk
Menaxhimi i burimeve njerezore	Nuk ka vende vakante, por nevojiten specialist IT dhe punonjes ne disa hidrovore pasi jane objekte te rendesise se vecante	Risk i mesem
Arkivimi dhe administrimi i dokumenteve	Protokollieshte unifikuar ,me protokoll dhe arkivimi sipas rregullave	Pa risk
Arritja e rezultateve optimal dhe të qëndrueshme të zhvillimit dhe të menaxhimit të istemit të ujitjes,kullimit dhe mbrojtjes nga permbytjet.(zbatimi i te gjitha projekteve te miratuara nga MBZHR)	Nevojitet me shum mjete per specialistet dhe tekniket e mesem te institucionit pasi eshte nje hapsire e madhe per qenien afer ne kohe te cdo problemi.	Risk i mesem

- Masat per menaxhimin e rrisqeve

Nr	Masa e marre	Afati	Pergjegjesi
1	Kerkesa ne MBZHR shtese fuqi punetore	2025	Titullari i DUK Fier
2	Kerkese ne MBZHR ne PBA 2026-2028 per blerje mjete dhe kompjutera	2025	Titullari i DUK Fier
3	Rritja e transparences ne procesin e menaxhimit te burimeve njerezore	2025	Kordinatori i integritetit
4	Monitorimi i rregullt i planit te integritetit	Cdo 6 muaj	Kordinatori i integritetit

- Monitorimi i planit te integritetit

Aktiviteti	Frekuenca	Pergjegjesi
Mbledhja e tedhenave per zbatimin e planit	Cdo 6 muaj	Kordinatori i integritetit
Raportimi i progresit	Vjetor	Titullari i DUK Fier
Publikimi i rezultateve	Cdo vit	Institucioni dhe MBZHR

1. Perfundime dhe rekomandime

4.1 Perfundime

Nga monitorimi i deritanishem rezulton se :

- Institucioni ka bere perparime te dukshme ne zbatimin e planit te integritetit ,sidomos ne menaxhimin financiar dhe arkivimin e dokumentacionit .
- Veshtiresit ne lidhje me mungesen e mjeteve per ofrimin e sherbimeve ne terren dhe burime njerezore
- Transparenca dhe monitorimi i vazhduaeshem jane permisuar ,por ka ende hapsire per permisimin dhe rekrutimin dhe dixhitalizimin e sherbimeve .

1.2 Rekomandime

Permisimi i burimeve njerezore duke shtuar punonjes ne hidrovore dhe specialist IT

- Dixhitalizimi i dokumentacionit .kalimi ne sisteme dixhitale per arkivimin e dokumentacionit
- Sigurimi i mjeteve transportit per DUK Fier pasi ka nje shtrirje te gjere dhe mjetet qe ka jane pothuajse te amortizuara .
- Rritja e transparences publikimi i raportimeve periodike mbi aktivitetin e instituconit dhe shpenzimet institucionale

2. Perfundim

Zbatimi i planit te integritetit ne DUK Fier ka apsur ecuri pozitive ,me perparime ne disa fusha .megjithate disa sfida mbeten ende te pa zgjidhura dhe kerkojme permisime te metejshme per arrtjen e objektivave te planit 2025

Data _____01..2026

Kordinatori integritetit : Evarist Kolici

